



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË
ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË
QENDRA BURIMORE PËR NXËNËSIT QË NUK DËGJOJNË TIRANË

Rruga "Hafëz Ibrahim Dalli" Nd.5 ; Tel 069 608 2456 ; Email: institutinxnukdegjojne@yahoo.com

Nr. Prot. 162

Tiranë, më 12 / 11 / 2025

URDHËR

PËR SHPALLJEN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

- bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 7995, datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar; Pikat 3 dhe 4, të Kreut 2. Të VKM-së Nr. 1074, datë 23.12.2015,
- Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 93/2014, datë 31.07.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara";
- Mbështetur në VKM-në nr. 148, dt. 13/03/2024 "Për Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Mbylljen dhe riorganizimin e Institucioneve të arsimit Special në Qendra Burimore, si dhe për Mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Tyre";
- si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.449 datë 29.08.2024 "Për Miratimin e Riorganizimit të Institucionit "Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë" në Qendër Burimore, Emërtesës, Strukturës dhe Organikës",
- Urdhrin Nr. 90 dt. 30. 04. 2024 "MIRATIMIN E RREGULLORES TIP PËR RIOGANIZIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT SPECIAL NË QENDRA BURIMORE SI DHE MËNYRËN E RIOGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TYRE.",
- Rregullores së Brendshme e nevojave specifike për mbarëvajtjen në Qendrën Burimore për Nxënësit që Nuk Dëgjojnë

në vijim njofton si më poshtë:

Shpalljen Për Konkurs Për Vendin E Punës Në Pozicionin "Specialist i kërkim zhvillimit dhe përshtatjes së asyeshme", 2 (dy) pozicione, Departamenti i kërkim zhvillimit dhe përshtatjes së asyeshme, Në Qendrën Burimore Për Nxënësit Që Nuk Dëgjojnë.

Kategoria/ klasa e pagës: klasa ... në zbatim të VKM-së Nr. 425

1. Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit:

Adresa: Rruga e Dibrës, pranë Medresesë Tel: 069 608 2456 Web: nxënësitqë nuk dëgjojnë.edu.al

1.1 Kërkesa të përgjithshme për tu punësuar në Departamentin e kërkim zhvillimit dhe përshtatjes së asyeshme janë:

- a) Kriteria të përgjithshme;
- b) Të jetë shtetas shqiptar
- c) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- d) Të mos jetë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale;

1.2 Kërkesa të veçanta:

- a) Të jetë pajisur me diplomë të ciklit të dytë të studimeve, me prioritet në fushat e pedagogjisë, Shëndetit Publik, Psikologjisë së Edukimit apo Shkencave Sociale (në përputhje me nevojat specifike për këtë vend të veçantë pune);
- b) Të zotërojë njohuri bazë në kompjuter;
- c) Zotërimi i gjuhëve të huaja. (përbën avantazh gjuha angleze) (certifikata, dëshmi).
- d) Të ketë njohuri të Gjuhës së shenjave.

2. Kriteret e Veçanta / të Posaçme të kualifikimit:

2.1 Kanë prioritet kandidatët që krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit plotësojnë dhe kërkesat e veçanta/posaçme të kualifikimit:

Eksperienca e mëpërparshme/fundit e punësimit në Administratën Shtetërore/Private (Në pozicione/sektore të njëjtë me pozicionin e punës për konkurim, apo të përafërt/ngjashëm me të);

Në formularin e vlerësimit të fundit nga eprori direkt, apo rekomandime pozitive nga punëdhënësi të mëpërparshëm.

3. Dorëzimi i Dokumentacionit:

Kandidatët aplikantë për këtë pozicion pune duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë interesi; për punësim/Shprehje
- b) Formulari për aplikim
- c) CV/Jetëshkrim; *kriter i detyrueshëm për kualifikim;*
- d) Fotokopje e dokumentit të identitetit (letërnjoftimi ID ose pasaportë); *kriter i detyrueshëm për kualifikim;*
- e) Certifikatë personale dhe certifikatë e gjendjes familjare;
- f) Dokument që vërteton përfundimin e nivelit arsimor që kërkon pozicioni i punës: Diploma e nivelit Master, sipas Listës së bashkëngjitur është kusht; *kriter i detyrueshëm për kualifikim;*
- g) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- h) Vërtetim të gjendjes gjyqësore nga prokuroria dhe gjykata;
- i) Dëshmi penaliteti;
- j) Vetëdeklarim të gjendjes së konfliktit të interesit;
- a. Formularin e Vlerësimit të fundit të punës nga eprori direkt;

- b. Vërtetim nga punëdhënësi aktual që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- c. Raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë;
- d. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve/kritereve të mësipërme të kualifikimit, si dhe trajnime, kualifikime, arsimim shtesë, vlerësime/rekomandime pozitive, apo të tjera të përmëndura në CV/Jetëshkrim.

(Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri.

3.1 Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit:

- a. Dokumentacioni do të dorëzohet në zyrën e arkiv-protokollit të institucionit, personalisht ose me postë, brenda orarit zyrtar të punës (e hënë- e premte nga ora 08.00 - 14.00), në adresën: Instituti i Nxënësve që Nuk Dëgjojnë, Rruga e Dibrës (pranë Medresesë), Tiranë;
- b. Dokumentacioni duhet të dorëzohet me postë ose dorazi nga aplikanti, në zyrën e arkiv-protokollit të institucionit brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin/ pranimin e dokumentacionit.
- c. Dokumentacioni duhet të dorëzohet gjithashtu në format elektronik në postën elektronike zyrtare të institucionit: email: institutinxnukdegjojne@yahoo.com

3.2 Afati i dorëzimit të dokumentacionit:

- a. Afati maksimal i dorëzimit/pranimit të dokumentacionit nga zyra e arkiv-protokollit të institucionit do të jetë (2) dy javë kalendarike, nga dita e nesërme e shpalljes së njoftimit në faqen e webit të QBNND-së: www.nxenesitqenukdegjojne.edu.al në rubrikën respektive: Vende të Lira Pune.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë data 26 / 11 / 2025
ora 14:00.

4 Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

1. Të hulumtojnë të dhëna rreth arsimit special për fëmijët me aftësi të kufizuar në dëgjim në qendrat burimore dhe në shkollat e zakonshme, në të cilat arsimohen fëmijët me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe të identifikojë metodat e mësimdhënies më të përshtatshme për nxënësit me vështirësi në dëgjim.
2. Të administrojnë pyetësorë dhe instrumente të tjera të kërkimit shkencor me bazë mbledhjen e të dhënave rreth metodave gjithëpërfshirëse të arsimit special për target-grupin në fjalë.
3. Të bashkëpunojnë me departamentin e përgatitjes së mjeteve didaktike dhe kurrikulës së përshtatur, për identifikimin e nevojave të stafit pedagogjik në institucionet e arsimit special dhe në qendrat burimore për nxënësit me aftësi të kufizuar në dëgjim.
4. Të bashkëpunojnë me departamentet e pedagogjisë së specializuar sociale në fakultetet që përgatisin mësues ndihmës dhe specialistë të mësimdhënies të arsimit special për nxënësit që nuk dëgjojnë, ata me vështirësi në dëgjim dhe ata me vështirësi në të folur.

Adresa: Rruga e Dibrës, pranë Medresesë Tel: 069 608 2456 Web: nxenesitqenukdegjojne.edu.al

6. Të propozojë dhe organizojë konferenca, simpoziume dhe tryeza pune.
7. Të aplikojë dhe përfaqësojë qendrën burimore në thirrje për projektet rreth arsimit special.
8. Të sigurojë pjesëmarrjen në vizita studimore në institute dhe qendra analoge.
9. Të përgatisë periodikisht raporte në kuadër të zhvillimit të politikave gjithëpërfshirëse në arsimin special.

5 Mënyra e përzgjedhjes/kualifikimit të kandidatëve

- a. Përzgjedhja/kualifikimi i kandidatëve do të kryhet e ndarë në 2 faza si më poshtë:
- b. 60 pikë nga vlerësimi i dokumentacionit të sipërcituar të depozituar nga kandidatët në institucion, nga komisioni i vlerësimit i ngritur për këtë qëllim;
- c. 40 pikë nga intervistimi me gojë i kandidatëve nga komisioni i vlerësimit, të cilët do të vlerësohen në lidhje me:

15 pikë nga njohurite, aftesitë në lidhje me punën;

15 pikë nga eksperiencat e tyre të mëparshme;

10 pikë nga motivimi, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për punën;

Si eksperiencë në profesion, e cila vlerësohet me max. 10 pikë, do të konsiderohet **VETËM eksperiencia në profesion.**

Intervista me gojë do të fokusohet në njohuritë profesionale të fushës së aplikimit (kërkimit shkencor me bazë mbledhjen e të dhënave rreth metodave gjithëpërfshirëse të arsimit special)

Brenda 2 (dy) ditëve pune, pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, kandidatët njoftohen mbi vlerësimin e Fazës I si dhe mbi vendin, datën dhe orën e zhvillimit të Fazës II (intervista me gojë).

Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit brenda dy ditëve që nga marrja e njoftimit. Ankesa bëhet në adresën elektronike zyrtare të institucionit.

6 Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri Sektori i arkivës dhe sekretarisë pranë institucionit;

7 Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ORJOLA IDRIS

DREJTOR



Adresa: Rruga e Dibrës, pranë Medresesë Tel: 069 608 2456

Web: nxenesitqenukdegjojne.edu.al